



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerrë:

Vendim Shpjegues Publik Nr. 1 / 2014 **për** **Të Ardhurat e Tatueshme nga Ndërtimi Afatgjatë**

Qëllimi

Qëllimi i VShP është të sqaroj detyrimet tatimore respektivisht mënyrën e deklarimit dhe pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe Tatimit në të Ardhurat Personale gjegjësisht Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për tatimpaguesit e angazhuar në projekte dhe kontrata afatgjate ndërtimore, që janë subjekt i Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2010 gjegjësisht Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2010.

Përkufizimet

Për qëllimin e këtij Vendimi Shpjegues Publik, definicionet në vazhdim kanë këtë kuptim:

- **“punë-kryes”** – ata që kryejnë punën ndërtimore (qoftë në mënyrë direkte ose nëpërmes të nën-kontraktorëve) –ata në përgjithësi paguhen nga një “investitor” i cili paguan në mënyrë progresive për punën ndërtimore, nëpërmes të një kombinimi të pagesave të avancit, pagesave progresive dhe pagesave finale
- **“investitorët”** – ata që financojnë punën e kontratës ndërtimore dhe që paguajnë “punë-kryesin” për atë punë.
- **“punëkryes-investitor”** ata që edhe e financojnë edhe e kryejnë punën e kontratës ndërtimore vetë.

